



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.10.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Shemsije Llugiqi (Udhëheqëse e ekipit) dhe Erëmira Bytyqi-Pllana (Anëtare e ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Arvita Zyferi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	24
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	25
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	28
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	31

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 20/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar


Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetaren dhe stafin e saj për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Menaxhmentit të KQZ-së – auditimi 2016**

Menaxhmentit të KQZ-së ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Menaxhmenti i KQZ-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetarja është përgjegjëse për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Kërkesat buxhetore, raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat financiare nëntëmujore;
- Planin vjetor të prokurimit dhe raportin vjetor të kontratave të nënshkruara; dhe
- Raportimin mujor të obligimeve të papaguara;

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në MF, konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në raport me dy vitet e fundit, menaxhmenti i KQZ-së ka bërë përmirësime të theksuara në aranzhimet e qeverisjes së mirë. Raportimi ishte në nivel të duhur. Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar ka nxjerrë në pah një raportim të mirë financiar mbi shpenzimet e krijuara.

Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të KQZ-së. Një pjesë e rekomandimeve të auditimit të jashtëm nuk janë zbatuar tërësi. Po ashtu, identifikimi dhe menaxhimi i rrezikut për mënjanimin e pengesave të mundshme krahas përmbushjes së objektivave nuk ka arritur të finalizohet deri në fund të vitit 2016. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga KQZ në disa raste nuk e pasqyron plotësisht situatën reale, shoqëruar me disa komente pozitive mbi aranzhimet ekzistuese që nuk bazohen në mjaftueshëm në dëshmi.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të KQZ-së ka rezultuar me 12 rekomandime kryesore. KQZ kishte përgatitur një Plan Veprimi, ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Zbatimi i rekomandimeve është trajtuar si element i rëndësishëm për eliminimin e dobësive dhe zvogëlimin e rreziqeve. Këtë e dëshmon fakti se në planin Vjetor të Auditimit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, në të cilin ishte vendosur si temë e veçantë “Zbatimi i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP) për vitin 2015”.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, katër (4) rekomandime janë zbatuar, shtatë (7) janë në proces të zbatimit dhe një (1) nuk është zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraparak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Ndonëse menaxhmenti ka zbatuar një proces formal të menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të vitit të kaluar të AP-së, nuk është arritur që plani i veprimit të përmbushet në tërësi. Një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve kanë mbetur të pa zbatuara plotësisht. Si pasojë e kësaj çështjet e njëjta që kanë të bëjnë me ndarjen e papërshtatshme të detyrave, planifikimin jo të mirë të buxhetit sipas kategorive ekonomike, vonesat në realizimin e kontratave, mbajtjen e pozitave me ushtrues detyre përtej afatit ligjor, si dhe menaxhimin jo të mirë të automjeteve janë përsëritur edhe këtë vit.
- Rreziku** Zbatimi jo i plotë i rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin e kontrolleve të brendshme në sistemet kryesore financiare dhe menaxheriale, dhe si rezultat kemi përsëritjen e mangësive të njëjta nga viti në vit.
- Rekomandimi 1** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprime shtesë me qëllim të zbatimit të plotë të rekomandimeve të AP-së sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme dhe aty ku rekomandimet janë përsëritur. Një monitorim sistematik nga ana e menaxhmentit është i nevojshëm për të siguruar zbatim efektiv të rekomandimeve dhe brenda afateve të përcaktuara.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të MFK-së, të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për vitin 2016 më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 – Pyetësi i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi vërejtur se pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga KQZ nuk e pasqyron plotësisht gjendjen për të cilën është pohuar, si:

1. Procesi i miratimit të përshkrimit të detyrave të punës për çdo pozitë pune, në të cilën përfshihen detyrat individuale, konsiderohet si i vendosur, përderisa dëshmitë nuk e vërtetojnë këtë pohim;
2. Dëshmitë e vërtetuan se për vite me radhë KQZ nuk ka arritur të zhvillojë procedura për plotësimin e pozitave të parashikuara dhe të buxhetuara dhe ndërprerjen e mbajtjes së pozitave menaxhuese me UD, përderisa në pyetësor është pohuar e kundërta;
3. Dëshmitë e vërtetuan se zyrtari certifikues i kishte raportuar Kryeshefit Ekzekutiv në rastet kur ekzekutimi i pagesës ishte i kundërligjshëm, ndërsa në pyetësor është pohuar e kundërta;
4. Në mungesë të kontrolleve ka dështuar kompletimi i regjistrave të pasurisë në bazë të kërkesave ligjore, edhe pse sipas vlerësimit të dhënë në pyetësor kjo çështje është vlerësuar si funksionale; dhe

5. Udhëzimet e përcaktuara me procedurat e MFK-së dhe rregullores 01/2010 kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për ta mbështetur menaxhimin efektiv, operacional dhe strategjik. Menaxhmenti i KQZ-së ka iniciuar procesin e identifikimit të rreziqeve në nivel të departamenteve ku ka kërkuar që secili prej tyre të përgatisin listën e rreziqeve bazuar në planin strategjik, aktivitetin dhe specifikën e secilit departament, rrethanat kur veprohet (periudha zgjedhore dhe jo zgjedhore) dhe faktorët e tjerë, të cilët konsiderohen të rëndësishëm për t'u përfshirë. Megjithatë, edhe pse ishin identifikuar rreziqet në nivel të departamenteve dhe ishte përgatitur lista e konsoliduar e rreziqeve, ky proces ende nuk është finalizuar. Sipas vlerësimeve të menaxhmentit të KQZ-së procesi pritet të finalizohet në muajin qershor të vitit 2017.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 2 Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se është rishikuar plotësisht i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm efektiv për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për ta siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit KQZ operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

KQZ-ja ka vendosur një sërë kontrollesh të brendshme, me qëllim të funksionimit sa më të mirë të sistemit financiar dhe kontrollit. Kontrollat janë të vendosura në atë mënyrë, që e përfshijnë raportimin e rregullt tek menaxhmenti, me qëllim të informimit me kohë dhe mundësisë për t'u përballur me sfidat dhe problemet e raportuara, në synim të arritjes së objektivave.

Kryeshefi ekzekutiv, pas këshillave tona e kishte praktikuar që takimet të përcillen me procesverbale, të cilat dëshmojnë se menaxhmenti i ka shqyrtuar çështjet dhe ka nxjerrë vendime për eliminimin e problemeve që janë me interes për qeverisje të mirë të organizatës.

Megjithatë, nga rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në këtë aspekt ka rezultuar se organizimi i brendshëm në disa raste nuk është në përputhje me strukturën organizative të aprovuar me rregulloren e brendshme.

Çështja 3 – Organizimi i brendshëm jo në pajtim me strukturën organizative – Prioritet i lartë

- E gjetura** Në korrik të vitit 2013 KQZ e ka aprovuar Rregullorën nr. KQZ-01/2013 për organizimin dhe strukturimin e brendshëm të Sekretariatit të KQZ-së. Pjesë e kësaj rregulloreje është edhe organogrami apo struktura organizative.
- Përkundër rekomandimit tonë të përcjellë nga viti në vit, lidhur me mos përputhjen në mes organizimit hierarkik aktual dhe strukturës organizative të përcaktuar me Rregulloren përkatëse, e njëjta situatë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016. Udhëheqësi i Departamentit për Administratë dhe Përkrahje (DAP), ushtron edhe detyrën e Zyrtarit Kryesor Financiar, përderisa Rregullorja e përcakton se Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa njëkohësisht është edhe Zyrtarit Kryesor Financiar.
- Rreziku** Organizimi i brendshëm jo në pajtim me kërkesat ligjore dhe rregulloren e brendshme mund të ndikojë në mos definimin e qartë të përgjegjësive dhe llogaridhënies, ku mund të ketë ndikim në efikasitetin operacional.
- Rekomandimi 3** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se organizimi i brendshëm i sekretariatit të KQZ-së bëhet konform strukturës organizative të përcaktuar me Rregulloren aktuale dhe në pajtim me kërkesat ligjore.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) e kishte përmbushur programin vjetor të auditimit, duke realizuar pesë (5) auditime sa ishin planifikuar. Hartimi i planit është përgatitur duke u bazuar në nivelin e rrezikut për sistemet dhe proceset e përfshira në auditimin e vlerësuar nga NjAB dhe në fushat me prioritet të lartë të vlerësuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në vitin 2015.

Përmes raportit të auditimit, menaxhmentit i janë ofruar informata dhe vlerësime për funksionimin dhe efikasitetin e kontrolleve të brendshme. NjAB në kuadër të departamentit të administratës dhe përkrahjes ka kryer dy (2) auditime sipas planit vjetor. Raporti i tretë i auditimit ka të bëjë me Departamentin e operacioneve zgjedhore (DOZ) që e përfshin auditimin e projekteve zgjedhore. Në planin Vjetor të Auditimit ishte vendosur edhe auditimi i zbatimit të rekomandimeve të nxjerra nga AP për vitin 2015, ndërsa auditimi i pestë në departamentin e prokurimit është finalizuar në fillim të vitit 2017.

Komiteti i auditimit (KA) deri në muajin shtator kishte mbajtur katër (4) takime. Rekomandimet e nxjerra nga AP dhe çështjet e ngritura në raportet e auditimit të brendshëm ishin vlerësuar dhe trajtuar nga KA. Në raportet e auditimit të brendshëm janë dhënë gjithsej 25 rekomandime, dhe sipas raportit të KA pjesa më e madhe e rekomandimeve të NjAB-së janë zbatuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës, të cilët e sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve dhe proceseve tjera të kontrollit. Sa i përket KQZ-së, gabimet në procedimin e pagesave, pagesat e punonjësve me vendime jo valide, mangësitë në menaxhimin e pasurisë dhe menaxhimi jo i mirë i automjeteve zyrtare edhe më tutje mbesin sfidat kryesore, me të cilat po përballen nga viti në vit.

Është e nevojshme të vlerësohet secila prej shkaqeve që kanë ndikuar në performancën jo të mirë të ekzekutimit të buxhetit, në mënyrë që të përcaktohet mënyra e adresimit dhe eliminimit të tyre në vitet e ardhshme.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	5,439,152	5,399,423	5,369,042	5,228,119	9,501,868
Granti i Qeverisë -Buxheti	5,439,152	5,397,846	5,369,042	5,228,119	9,501,868
Donacionet e jashtme	-	1,577	-	-	-

Në vitin 2016, KQZ ka përdorur 99% të buxhet final ose 5,369,042€, krahasuar me vitin e kaluar nuk kishte pësuar ndonjë ndryshim në përqindje të ekzekutimit të buxhetit. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	5,439,152	5,399,423	5,369,043	5,228,119	9,501,868
Pagat dhe Mëditjet	744,492	757,036	756,384	714,800	719,517
Mallrat dhe Shërbimet	436,269	411,289	381,570	285,133	4,472,974
Shërbimet komunale	48,391	22,653	22,644	29,513	41,461
Subvencionet dhe transferet	4,200,000	4,198,550	4,198,550	4,198,673	4,160,674
Investimet Kapitale	10,000	9,895	9,895	-	107,242

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 39,729€. Sipas kërkesës së KQZ-së, me rishikim të buxhetit, buxheti i aprovuar ka pësuar ndryshime në dy (2) programe dhe në dy (2) kategori. Ndërsa, pas shpalljes së datës për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në Drenas, KQZ-ja me shkresë i është drejtuar qeverisë për buxhet shtesë. Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Nga Sekretariati, përkatësisht nga mallrat dhe shërbimet janë transferuar në programin e Zgjedhjeve 20,000€ në njëjtën kategori ekonomike. Në kategorinë e shpenzimeve komunale janë bërë shkurtime buxhetore në vlerë prej 10,500€;
- Me vendimin numër 08/115, të datës 9 nëntor 2016, qeveria i ka ndarë KQZ-së mjete në shumë prej 221,544€, prej të cilave 12,544€ në programin e Sekretariatit për paga dhe mëditje dhe 209,000€ në programin e zgjedhjeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve;
- Me vendimin e qeverisë numër 01/123, të datës 28.12.2016 nga kategoria mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale u morën 233,980€ dhe 15,238€;
- Kategoritë investime kapitale dhe subvencione dhe transfere janë shkurtuar me vendim të qeverisë nr. 01/123, të datës 28 dhjetor 2016 për 105€ dhe 1,450€; dhe
- Mjetet e pa shpenzuara në kategoritë e lartcekura janë bartur në suficit me vendimin e qeverisë.

3.1.1 Të hyrat

KQZ ka realizuar të hyra nga subjektet politike në shumë prej 2,500€. Këto të hyra janë realizuar me rastin aplikimit për regjistrim të subjekteve politike në shumë prej 1,500€, dhe në emër të gjobave subjektet politike kanë paguar 1,000€. Mjetet e grumbulluara janë transferuar në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Shpenzimet për kategorinë e pagave dhe mëditjeve në KQZ për vitin 2016 ishin 756,384€ apo 99% e buxhetit të aprovuar. Ne kemi testuar 13 mostra për testet substanciale dhe 11 të pajtueshmërisë. Kontrollat në fushën e burimeve njerëzore nuk ishin plotësisht efektive. Më gjerësisht, mangësitë janë paraqitur në vijim:

Çështja 4 - Anashkalimi i kërkesave ligjore me rastin e kompensimit të stafit - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas ligjit për shërbimin civil, neni 38, shuma totale e orëve jashtë orarit të punës nuk mund të lejohet më shumë se 40 orë në muaj. KQZ, me rastin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në Glllogoc, kishte marrë vendim për zgjatjen e orarit të punës për stafin e SKQZ-së, ku tejkalohej nr. i lejuar i orëve të përcaktuara sipas normave ligjore. Gjithashtu, pagesa për punë jashtë orarit nuk ishte bërë në përputhje me normat e përcaktuara ligjore. Për punën jashtë orarit për muajt nëntor dhe dhjetor stafi ishte paguar me 60% të pagës bazë plus shujta në vlerë prej 100€. Për këtë mënyrë të pagesës nuk kishte ndonjë vendim valid, por menaxhmenti ishte bazuar në vendimin e marrë në vitin 2014, vendim i cili kishte skaduar po atë vit. Shtesat ishin paguar edhe për anëtarët e KQZ-së, pa ndonjë bazë ligjore.
- Rreziku** Kompensimi i shtesave në mospërputhje me kërkesat ligjore, rrezikon shpenzimin e buxhetit në mënyrë joefikase.
- Rekomandimi 4** Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë që angazhimet dhe pagesat e stafit për punë jashtë orarit të bëhen në përputhje me normat e lejuara ligjore.

Çështja 5 - Tejkalimi i afatit ligjor për pozitat me ushtrues detyre - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas ligjit për shërbimin civil, neni 30, në rast të pozitave të lira, Ushtruesi i Detyrës (UD) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj. Në KQZ gjashtë (6) pozita menaxheriale vazhdojnë të mbulohen me UD që nga viti 2013. Përkundër rekomandimeve të dhëna, e njëjta situatë ka vazhduar nëpër vite. Këtë vit, nuk ishte zhvilluar asnjë konkurs për pozitat në fjalë.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave menaxheriale me UD përtej afatit ligjor e rrezikon realizimin e performancës efektive në departamente, duke ndikuar në mosrealizimin e objektivave të përcaktuara në nivel të organizatës.
- Rekomandimi 5** Kryetarja e KQZ-së, të ndërmarrë hapa konkret që të sigurojë që pozitat e mbuluara me UD të plotësohen me staf me kontratë të rregullt, përmes një konkurrence të hapur.

Çështja 6 - Mangësitë në dosjet e personelit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në bazë të rregullores 03/2010 për përshkrimet e vendit të punës, çdo institucion është i obliguar të sigurojë ekzistimin e përshkrimit të vendeve të punës për të gjitha vendet e punës që i posedon. Nga dosjet e personelit të ekzaminuara e kemi vërejtur që mungojnë përshkrimet e vendeve të punës. Nuk ka ndonjë arsye specifike pse kishte ngecur ky proces.
- Rreziku** Mungesa e përshkrimeve të vendit të punës rrezikon moskryerjen e objektivave nga nëpunësit e duhur në bazë të kërkesave për pozitat përkatëse. Kjo gjithashtu nuk e siguron shpërndarjen racionale të detyrave dhe përgjegjësiive brenda institucionit.
- Rekomandimi 6** Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se janë përmbushur kërkesat për plotësimin e përshkrimit të vendit të punës për çdo pozitë brenda institucionit.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Shpenzimet për vitin 2016 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve/komunalive, ishin 404,214€ apo 93% e buxhetit të aprovuar. Ne kemi kryer 23 teste substanciale si dhe katër (4) procedura të prokurimit për pajtueshmëri. Testimet tona kanë rezultuar me mangësitë në vijim:

Çështja 7 - Pagesat e stafit në mungesë të vendimit dhe të dëshmive - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 78, për pagesat e anëtarëve dhe kryesuesve të Këshilli i Vendvotimeve, KQZ nxjerr një vendim të veçantë me të cilin e rregullon këtë çështje. KQZ, për stafin e angazhuar në qendra të vendvotimeve, nuk kishte nxjerrë një vendim mbi mënyrën e pagesës së tyre, por pagesën e kishte bërë sipas një vendimi të nxjerrë për zgjedhjet lokale të vitit 2013. Gjithashtu, në tri (3) raste të pagesës së stafit teknik, mungonin kontratat si dhe evidencat për pjesëmarrje në vendvotim.
- Rreziku** Pagesat e bazuara në vendime jovalide, rrezikojnë realizimin e pagesave të parregullta dhe jo në përputhje me ligjin. Mungesa e dëshmive rreth angazhimit të stafit, rrezikon mundësinë që stafi i paguar të mos ketë qenë realisht i angazhuar në kryerjen e detyrave për të cilat është paguar.
- Rekomandimi 7** Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se çështja e pagesës së stafit të angazhuar për procese zgjedhore, të rregullohet me vendim të veçantë, i cili është valid për zgjedhjet përkatëse.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Me ligjin e Buxhetit për vitin 2016, në kategorinë e Subvencioneve ishin ndarë 4,200,000€, mjete këto të dedikuara për mbështetjen e subjekteve politike. Ky fond shfrytëzohet për financimin e aktiviteteve të rregullta të partive politike, punën e grupeve parlamentare dhe aktiviteteve parazgjedhore dhe zgjedhore. Mjetet e fondit ndahen në mes subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend të Kosovës në bazë të numrit të vendeve/ulëseve për atë mandat.

Deri në fund të vitit ishte shpenzuar i tërë buxheti nga kategoria përkatëse për qëllimin e lartëcekur. Pagesat ishin certifikuar pas secilës periudhë tremujore dhe vetëm pasi subjektet politike kishin dorëzuar në KQZ raportin bankar së bashku me raportin financiar të tremujorit paraprak, si dhe faturat e shpenzimeve nga grupet parlamentare të subjekteve politike.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 9,895€ dhe e tërë vlera e buxhetuar ishte shpenzuar për furnizim me Pajisje të IT-së. Ky aktivitet ishte planifikuar me plan të prokurimit. Testet tona shpalosen se procedura e prokurimit ishte zhvilluar në pajtueshmëri me LPP. Megjithatë sa i përket kompletimit të dokumentacionit për nevoja të regjistrimit në SIMFK e vërejtëm se urdhër blerja ishte nxjerrë para nënshkrimit të kontratës. Shih çështjen 12 për më shumë detaje.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 8 – Dobësi procedurale gjatë procedimit të pagesës – Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullës financiare 01/2013, urdhërblerja krijohet dhe përgatitet nga ana e organizatës buxhetore, pas nënshkrimit të kontratës. Te kontratat për “Mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve” dhe “Furnizim me paisje të IT-së” fillimisht ishte lëshuar urdhërblerja, e më pas ishte nënshkruar kontrata. Sipas zyrtarit të prokurimit, urdhërblerjet ishin përgatitur paraprakisht në mënyrë që jenë të gatshme për operatorin për shkak të mosfunksionimit eventual të sistemit për procedimin e urdhërblerjes.

Sipas Rregullës Financiare 01/2013, neni 22, procesit për inicimin e shpenzimit, i paraprin kërkesa për blerje, urdhërblerja, raporti për pranimin e mallit dhe më pas fatura. Gjithashtu kjo rregull specifikon se çdo faturë e pranuar duhet të paguhet brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimit. Në pagesën e testuar për furnizim me material administrativ në vlerë 2,416€, pranimi i faturës/furnizimi ishte bërë në mungesë të zotimit të mjeteve dhe urdhërblerjes. Kjo kishte shkaktuar gjithashtu pagesën e faturës së pranuar pas afatit të përcaktuar ligjor. Sipas Zyrtarit Kryesor Financiar, kjo kishte ndodhur për shkak se në kohën kur ishte bërë porosia kishte kaluar afati i zotimeve, ndërkaq furnizimi ka qenë i nevojshëm për fundvit. Vonesë në pagesën e faturave kishte gjithashtu tek pagesa për “Mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve” ku pesë fatura në vlerë 3,546€ ishin paguar pas afatit ligjor. Kjo vonesë kishte ndodhur si pasojë e vonesës në rregullimin e disa veturave dhe pritjes që të kompletohen të gjitha faturat në një pagesë.

Rreziku Nxjerrja e urdhërblerjes para nënshkrimit të kontratës, furnizimi/pranimi i faturës në mungesë të mjeteve të zotuarra dhe vonesat në pagesën e faturave janë në kundërshtim me rregullën financiare për shpenzimin e parasë publike dhe si pasojë shkaktojnë hyrjen në obligime para kohës si dhe rritjen e obligimeve të papaguara.

Rekomandimi 8 Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se stafi përgjegjës respekton hapat e përcaktuar ligjor mbi procesin e shpenzimeve, përgatitja e urdhërblerjeve bëhet vetëm pas nënshkrimit të kontratës dhe faturat e pranuar paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Për vitin 2016, vlera totale e pasurisë ishte 376,804€. Vlera neto e pasurisë mbi 1,000€ ishte 137,814€, ndërsa vlera neto e pasurisë nën 1,000€ në ishte 231,920€. Vlera e stoqeve ishte 7,070€. Përkundër disa përmirësimeve në raport me vitet e kaluara në menaxhimin e pasurisë, mangësi të shumta janë vërejtur edhe këtë vit. Çështjet e identifikuar, janë paraqitur më gjerësisht, si më poshtë.

Çështja 9 - Menaxhimi jo i mirë i pasurisë - prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas Rregullores 02/2013 për pasuritë jo financiare, neni 22, vlerësimi i pasurive bëhet duke marrë parasysh zhvlerësimin e akumuluar nga momenti i blerjes, bazuar në normat e zhvlerësimit të përcaktuara me këtë rregull. Gjatë testimit të e-pasurisë, ne kemi vërejtur se zhvlerësimi i pasurive nuk është bërë konform normave të përcaktuara, me ç' rast pasuritë janë zhvlerësuar në vlerë më të vogël në raport me normat e përcaktuara të zhvlerësimit. Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos aplikimit të zhvlerësimit të pasurive për një kohë të gjatë.
- E gjetura** Sipas Rregullores 02/2013 për pasuritë jo financiare, neni 14, Zyrtari i pasurive jo financiare do t'i regjistrojë në mënyrën e duhur të gjitha pasuritë në regjistrin e pasurive dhe në regjistrat kontabël në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se pasuria është në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore. Në regjistrin e pasurive kapitale, figuron "Kamera Dixhitale Sony", e cila është jashtë përdorimit, por që për këtë pasuri nuk ka evidencë të hyrjes në depo dhe dëshmi se ajo është pronë e organizatës.
- Rreziku** Zhvlerësimi jo i saktë i pasurisë ndikon në mosparaqitjen e vlerës së saktë të pasurisë jo kapitale, në këtë rast duke mbivlerësuar atë. Poashtu mos evidentimi i pasurive që ndodhen brenda KQZ-së rrezikon humbjen apo keqpërdorimin e tyre.
- Rekomandimi 9** Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se merren masa për aplikimin e normave të përcaktuara të zhvlerësimit për pasuritë jo kapitale në mënyrë që menaxhmenti të ketë informata të plota mbi pasurinë që e posedon.

Çështja 10 – Mangësi në procesin e vlerësimit dhe inventarizimit të pasurisë – Prioritet i lartë

E gjetura Sipas Rregullës Financiare mbi pasurinë jo financiare, neni 9, tjetërsimi i pasurisë bëhet në bazë të rekomandimit nga komisioni i vlerësimit të pasurisë sipas vlerësimit të pasurisë së papërdorshme dhe jashtë funksionit të organizatës. Në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e pasurisë, kryer me dt. 22.12.2015, KQZ është rekomanduar që të bëjë tjetërsimin e një numri të madh pajisjesh të vlerësuara si jo-funksionale. Megjithatë, ende nuk ishin ndërmarrë hapa konkret mbi procesin e tjetërsimit siç është formimi i komisionit për tjetërsim dhe hapat tjerë të paraparë me rregullore.

Sipas Rregullës Financiare për Pasuritë jo financiare, neni 19, komisioni i inventarizimit duhet të bëjë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur si dhe atyre të dëmtuara dhe jashtë përdorimit. Komisioni i caktuar për inventarizim në KQZ-së, në fund të vitit 2016, kishte regjistruar gjithë pasurinë në pronësi të KQZ-së. Megjithatë, ky komision nuk kishte harmonizuar gjendjen e inventarizuar me regjistrat e pasurive jo financiare dhe nuk ishte bërë asnjë konstatim në lidhje me gjendjen fizike të pasurive. Kjo për arsye se komisioni nuk kishte qenë i familjarizuar me përgjegjësitë e plota rreth procesit të inventarizimit.

Rreziku Dështimi mbi kryerjen efektive të procesit të inventarizimit dhe tjetërsimit të pasurive, ndikon në ekspozimin e pasurive pranë rrezikut të humbjes, paraqitjen e gjendjes joreale të pasurive në PVF, si dhe vështirëson vendimmarrjen e menaxhmentit lidhur me pasuritë, si pasojë e mungesës së të dhënave të sakta.

Rekomandimi 10 Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se janë ndërmarrë hapat konkret mbi zbatimin e rekomandimit për tjetërsimin e pasurive të vlerësuara si të dëmtuara dhe të panevojshme për organizatën. Gjithashtu të sigurojë se komisioni i caktuar për inventarizim njoftohet mbi përgjegjësitë për kryerjen efektive të këtij procesi, duke krahasuar gjendjen aktuale të pasurive me regjistrat e pasurive jo financiare, dhe përgatitjen e një raporti të plotë mbi vërtetimin e saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurive.

Çështja 11 - Pranimi i mallrave/shërbimeve në mungesë të komisionit të pranimit - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas Rregullës Financiare 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 8, Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon komisionin për pranimin e pasurisë jo financiare. Nga testimet tona kemi vërejtur se tek pagesa në vlerë 786€ (Furnizim me toner) nuk ishte caktuar komision për pranimin e mallit. Kjo kishte ndodhur për shkak se kishin konsideruar se për pasuri të caktuara nuk nevojitet komision për pranim.

Rreziku Pranimi i mallit në mungesë të komisionit të pranimit, mund të shpie në pranimin e mallit jocilësor dhe jo në përputhje me kushtet e kontraktuara.

Rekomandimi 11 Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se më tutje veprohet sipas kërkesës së rregullës financiare dhe në rastin e pranimit mallit formohet komisioni i pranimit.

Çështja 12 - Menaxhimi jo i duhur i automjeteve zyrtare - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas UA nr.03/2008 mbi përdorimin e veturave zyrtare, neni 3, thekson se në raste të caktuara, nëpunësve të caktuar, për shkak të specifikave të veçanta të punës, me vendim të ministrit të ministrisë përkatëse, mund t'iu lejojehet përdorimi i automjeteve zyrtare me propozim të sekretarit apo Kryeshefit Ekzekutiv.

KQZ posedon 11 automjete, ku dhjetë (10) prej tyre shfrytëzohen 24h nga anëtarët e KQZ-së, bazuar në UA të brendshëm mbi përdorimin e automjeteve zyrtare, i cili ua lejon anëtarëve shfrytëzimin e veturave 24h, duke mos specifikuar arsyen apo specifikat e veçanta të punës së tyre, si bazë mbi autorizimet e dhëna. Në autorizimin e lëshuar nga Kryeshefi Ekzekutiv, përdoruesve ju lejohej përdorimi i automjetit edhe jashtë vendit, ndërsa një gjë e tillë nuk specifikohet në udhëzim administrativ. Për më tepër, nga dosjet e ekzaminuara të disa prej veturave të shfrytëzuara, nuk mbahen evidenca të plota lidhur me përdorimin e automjeteve. Evidenca mbi kërkesën dhe aprovimin për përdorim të automjeteve mungonin edhe nga një pjesë e stafit të KQZ-së, të cilët kishin shfrytëzuar automjetet zyrtare.

Rreziku Kontrolllet e dobëta mbi menaxhimin e automjeteve zyrtare të KQZ-së, rrezikojnë përdorimin e tyre për qëllime jozyrtare.

Rekomandimi 12 Kryetarja e KQZ-së, të rishikojë udhëzimet e brendshme dhe të sigurojë se ato janë në përputhje Udhëzimet e përgjithshme të Qeverisë, të sigurojë se kërkesat dhe raportimi mbi përdorimin e automjeteve janë të plota dhe të rregullta.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 79,171€. Obligimet e papaguara në krahasim me vitin paraprak ishin rritur për 78% (në fund të vitit 2015 ishin 17,422€). Obligimet ishin më të larta për arsye se pjesa më e madhe e tyre në vlerë 52,280€ ka të bëjë me pagesat e komisioneve të vendvotimeve dhe stafit ditor të angazhuar në qendrat e numërimit me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme në komunën e Drenasit.

Çështja 13 - Vonesa në pagesën e faturave dhe dobësi në raportimin e obligimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullës financiare 02/2013/MF, Organizatat buxhetore janë të obliguara t'i paguajnë faturat brenda 30 ditësh nga data e pranimit të faturës. Po ashtu të njëjtat duhet të raportohen në Thesar për çdo muaj (deri më datën 15-të muajit vijues) si obligime të pa paguara.

KQZ-ja në pesë (5) raste në vlerë 4,160€ ka pasur vonesa në kryerjen e obligimeve përtej afatit ligjor prej 30 ditësh dhe të njëjtat nuk ishin raportuar me kohë në Thesar. Kjo kishte ndodhur për shkak se faturat nuk ishin dorëzuar me kohë në zyrën e financave.

Rreziku Kontrollat jo të mira në raportimin e obligimeve rrisin rrezikun që faturat të mos identifikohen dhe të mos paguhen me kohë. Njëkohësisht, ndaj KQZ -së mund të paraqiten ndëshkimet për vonesa në pagesa.

Rekomandimi 13 Kryetarja e KQZ-së të sigurohet që obligimet paguhen brenda afatit ligjor, ndërsa faturat e papaguara raportohen në Thesar në pajtueshmëri me Rregullën financiare 02/2013 për raportimin e obligimeve.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetarja duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Pasqyrat Financiare	Kryetarja të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF-ve për vitin 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Detyrimet kontigjente në vlerë të parashikuar prej 115,000€ nuk janë shpalosur në PVF. Kryesisht këto detyrime ndërlidhen me pretendimet financiare që kanë operatorët ekonomik ndaj KQZ-së për- shkak të kontesteve rreth shpenzimeve dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit.	Po		
Zbatimi i rekomandimeve	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se plani i veprimt, i rishikuar, të përcaktojë qartë zyrarët përgjegjës dhe afatet kohore për zbatim.		Me gjithë progresin e arritur në disa fusha, një pjesë e rekomandimeve nuk është zbatuar ende.	
Qeverisja e mirë	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se është duke u zbatuar një rishikim i vlerësimeve të dhëna në pyetësorin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë aktive.		KQZ ka përgatitur pyetësorin e vetvlerësimit. Megjithatë në disa fusha ka nevojë të azhurnohet pasi që vlerësimet e bëra nuk mbulohehim me dëshmitë e duhura.	
Qeverisja e mirë	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek zyrarët përgjegjës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.		Ne proces të zbatimit, pasi që ishin identifikuar rreziqet në nivel të departamenteve dhe ishte përgatitur lista e konsoliduar e rreziqeve, mirëpo ende nuk është formalizuar lista e konsoliduar e rreziqeve.	

Qeverisja e mirë	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se organizimi i brendshëm i sekretariatit të KQZ-së bëhet konform strukturës organizative të përcaktuar me Rregullorën aktuale. Gjithashtu të bëhet një rishikim i rregullimeve ekzistuese të delegimit të përgjegjësive dhe llogaridhënies. Në rastet kur detyrat e KE ushtrohen përkohësisht nga ndonjë zyrtarë tjetër, delegimi i përgjegjësive duhet të evidentohet me shkrim dhe të dhënat të mbahen në Planin e delegimeve të MFsë.		Përkundër rekomandimit tonë të përcjellë nga viti në vit, në dy auditimet e fundit, ende vazhdon që Udhëheqësi i Departamentit për Administratë dhe Përkrahje (DAP), ushtron edhe detyrën e ZKF-së, përderisa Rregullorja përcakton se Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa njëkohësisht është edhe ZKF.	
Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë që në procesin e planifikimit buxhetor të angazhohen aktivisht edhe menaxherët e programeve buxhetore/njësit kërkuese. Procesi i vlerësimit dhe planifikimit të pasqyrojë tërë informacionin e duhur për nevojat vjetore të pritura.	Po		
Procedurat e prokurimit	Kryetarja të sigurojë se blerjet përmes prokurimit publik zhvillohen sipas kërkesave ligjore dhe udhëzuesve përkatës.	Po		
Prokurimi e prokurimit	Kryetarja e KQZ-së duhet të ndërmarrë veprime të duhura për të siguruar evitimin e mangësive të hasura. Menaxherët e kontratave duhet të aplikojnë formatin zyrtar të Planit për Menaxhimin e Kontratave dhe ta përditësojnë me informata rreth ecurisë së zbatimit dhe përmbushjes së kontratave.	Po		
Paga dhe mëditje	Kryetarja e KQZ-së të sigurojë se procedurat e rekrutimit për plotësimin e pozitave të lira fillojnë me kohë, dhe se për pozitat e udhëhequra me ushtrues detyre bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kërkesat ligjore.			Nuk është zbatuar.

Menaxhimi i pasurisë	Kryetarja të sigurojë se pasuritë evidentohen me barkode dhe se aplikohen normat përkatëse të zhvlerësimit për pasurinë e pa zhvlerësuar.		Rekomandimi në proces pasi që ende nuk është arritur që të kompletohet regjistri i E-pasurisë për të zhvlerësuar pasurinë sipas normave të parapara me rregullore.	
Menaxhimi i pasurisë	Kryetarja e KQZ-së të sigurojë se automjetet zyrtare shfrytëzohen dhe menaxhohen në pajtim me procedurat dhe rregullat ligjore.		Me gjithë përmirësimet e bëra, edhe këtë vit kemi hasur në dobësi në përgatitjen e kërkesave për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve sa i përket aspektit administrativ.	
Obligimet e papaguara	Kryetarja e KQZ-së të sigurohet se detyrimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor. Nëse për ndonjë arsye borxhet mbesin të papaguara, ato duhet të raportohen me kohë në MF/Thesar.		Përkundër evidencave të rregullta të raportimit të obligimeve të papaguara, është vërejtur se kishte vonesa në kryerjen e obligimeve dhe raportimin e tyre sipas afateve ligjore.	

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org]

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Enis Halimi.....

Kryeshef Ekzekutiv

Data: 28.06.2017

